



A.nr. 665/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Argjenda Sherifi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.665/2026, të datës 19.06.2026, të parashtruar nga ankuesja M.M-D, nga Prishtina të cilin më autorizim e përfaqëson avokat Agron Kajtazi, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 31.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.665/2026, e datës 19.06.2026, e parashtruar nga ankuesja M.M-D.

II. Mbetet në fuqi Akt Përgjigja me numër protokoli 910/2026, e datës 26.05.2026, e Udhëheqësit të Njesisë të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesja M.M-D (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 19.06.2026, ka parashtruar ankesë kundër përgjigjes me numër protokoll 910/2026, të datës 26.05.2026, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më të cilën është refuzuar kërkesa e ankueses për njohjen dhe pagesën e përvojës së punës 0.25% në 0.5%, nga hyrja në fuqi e Ligji i Pagave në Sektorin Publikë e deri me datë 31 dhjetor 2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 2764/2026 të datës 19.06.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankese e datës 23.06.2026; Kërkesën për

njohje dhe pagesën e përvojës së punës te datës 08.05.2026; Përgjigjen nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me numër 910/2026 te datës 26.05.2026; Autorizimin e Avokatit për ankuesin e datës 27.04.2026; Përgjigjen në ankese e datës 03.07.2026; Akt Emërimit e ankueses me numër ARC15/2012 të datës 05.12.2012; Lista e pagave për ankuesen.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses është e pabazuar, **sepse**:

Gjendja e çështjes

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se:

- Ankuesja sipas Aktit të Emërimit nr.Ref:ARC15/2012 të datës 05.12.2012, ushtron pozitën *Analiste e projekte* në Departamenti i Teknologjisë së Informimit dhe Komunikim në kuadër të Agjencisë për Regjistrim Civil.

-Ankuesja përmes përfaqësuesit të saj, më datë 08.05.2026 i është drejtuar më kërkesë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për njohjen dhe pagesën e përvojës së punës 0.25% në 0.5% dhe kompozimin retroaktiv nga hyrja në fuqi e Ligjit të Pagave në Sektorin Publikë e deri me datë 31 dhjetor 2025.

- Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 25.05.2026, përmes Akt përgjigjes në kërkesë me numër protokoll 910/2026, ka refuzuar kërkesën e ankueses të datës 08.05.2026, mbi arsyetimin se në mungesë të një autorizimi të veçantë që autorizon kompensimin retroaktiv për periudhën e kërkuar MPB nuk ka bazë ligjore dhe buxhetore për pagesa të tilla.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se punëdhënësi nuk ka përmbushur obligimin sepse dispozitat e nenit 6 paragrafi 6.1 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili është konstatuar nga Gjykata Kushtetuese si nuk ka qenë në përputhje me Kushtetutën. Andaj edhe mohimi i të drejtës për kompensimin e vlerës së përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, nga koha kur ha hyrë në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publik është mohim i të drejtës së fituar, sepse kjo e drejtë është njohur me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kërkon që ankesa të aprohet, të anulohet Përgjigja e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me numër protokoll Nr.910, e datës 26.06.2026, si dhe të obligohet Ministria e Punëve të Brendshme që ankuesit të ia njoh të drejtën e përvojës së punës në masën 0.5% për çdo vit pune, që nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.08/L-196, me datën 06.02.2023 e deri me datën 31 dhjetor 2025, si dhe të bëjë pagesën retroaktiv të diferencës në pagë, për çdo muaj ku është aplikuar gabimisht shtesa në nivelin 0.25%, duke filluar nga data 06.02.2023 e deri me datën 31 dhjetor 2025.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Lidhur me pretendimin e ankueses referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se:

“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për

çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrotja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë për qind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë **në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi.** Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë sipas aktgjykimit kushtetues dhe rrjedhimisht mbi këtë

bazë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk mund të trajtoj në meritë pretendimin ankimor lidhur me kompensimin për përvojën e punës sikurse pretendohet në ankesë.

Thënë më tepër, e bazuar në përcaktimet kushtetuese sipas Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, Këshilli tashme ka qëndrim të konsoliduar që rregullat dhe kushtet lidhur me pagat dhe kompensimet tjera të të punësuarve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i ligjit për pagat në sektorin publik, dhe se efektet e Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, referuar paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik do të rrjedhin nga data e publikim të këtij aktgjykimin (pra nga data 01.02.2024).

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.665/2026

Argjenda SHERIFI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit së ankueses Avokat Agron Kajtazi;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.